



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dotted Prijemno / Priloge Received / Priloge	27 - 11 2023	3	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	7121/2023		1111



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1223/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1223/2023 të datës 29.09.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë rruga [redacted] Lagja Marigona në Prishtinë, kundër Vendimit me numër DM 690/2023 të datës 28.09.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "Transferim për shkak të ristrukturimit", në mbështetje të Nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenit 16 paragrafi 3 dhe Nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1223/2023 e datës 29.09.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër DM 690/2023 i datës 28.09.2023, Vendimi me numër DM 692/2023 i datës 29.09.2023 i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- III. Anulohet Raporti i Punës 07/2023 dhe Raporti i Punës 08/2023 i Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndërsa lënda kthehet në Komisionin e Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
- IV. Obligohet Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi, duke marr parasysh pikëpamjet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.

V. Obligohet Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2022, ka nxjerr Vendim me të cilin ka aprovuar Rregulloren Nr. 07/2022 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Pas miratimit të kësaj rregulloreje, ka filluar procesi i ristrukturimit, ku Komisioni i Ristrukturimit i themeluar sipas Vendimit DM 184/2023 të datës 12.05.2023 ka nxjerr raportin e punës 04a/2023 lidhur me pozitën Menaxher i Zyrës Rajonale në Mitrovicë, mirëpo ky raport është anuluar sipas Vendimit A.nr.936/2023 të datës 01.09.2023 dhe sipas Vendimit A.nr.937/2023 të datës 04.09.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur më datë 04.09.2023, ka nxjerr Vendim me të cilin ka aprovuar Rregulloren Nr. 05/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me arsyetimin se është konstatuar nga Bordi se Rregullorja aktuale ka nevojë për rishikime/përmirësime. Sipas Rregullores Nr. 05/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, konkretisht sipas nenit 43 është shfuqizuar Rregullorja Nr. 07/2022 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërsa sipas vendimit të lartcekur kjo rregullore hyn në fuqi nga data 01.10.2023.

Drejtori i Burimeve Njerëzore i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datë 29.08.2023 ka nxjerr Vendimin DM 653/2023 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit, ndërsa sipas Vendimit me numër DM 666/2023 të datës 07.09.2023 është plotësuar vendimi DM 653/2023 kështu që Komisionit të Ristrukturimit i vazhdohet afati i punës për 30- ditë nga data e nxjerrjes së këtij vendimi, kjo është bërë me arsyetimin se është miratuar Rregullorja Nr.05/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me dy pozitat e lira të nivelit drejtues respektivisht për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë dhe Udhëheqës i Divizionit të Shitjeve Direkte ka nxjerr Raportin e Punës 07/2023 respektivisht Raportin e Punës 08/2023.

Në bazë të Raportit të Punës 07/2023, Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë, ka shqyrtuar aplikacionet e gjashtë (6) kandidatëve, duke konstatuar se të gjithë plotësojnë kriteret për këtë pozitë, mirëpo që sipas poentimit kandidatët janë renditur si më poshtë: kandidatja me inicialet B.B është vlerësuar me gjithsej 53 pikë, kandidati me inicialet A.K është vlerësuar me gjithsej 52 pikë, kandidati me inicialet V.H është vlerësuar me gjithsej 51 pikë, kandidati me inicialet F.M është vlerësuar me gjithsej 43 pikë, kandidati me inicialet N.K është vlerësuar me gjithsej 38 pikë dhe kandidati me inicialet D.B është vlerësuar me gjithsej 36 pikë, duke propozuar që sipas këtij poentimi kandidati me inicialet B.B të transferohet në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë, ndërsa kjo kandidate sipas Vendimit me numër DM 691/2023 të datës 29.09.2023 është transferuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë.

Ndërsa në bazë të Raportit të Punës 08/2023, Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Shitjeve Direkte, ka shqyrtuar aplikacionet e pesë (5) kandidatëve, duke konstatuar se të gjithë plotësojnë kriteret për këtë pozitë, mirëpo që sipas poentimit kandidatët janë renditur si më poshtë: kandidati me inicialet A.K është vlerësuar me gjithsej 52 pikë, kandidati me inicialet V.H është vlerësuar me gjithsej 51 pikë, kandidati me inicialet F.M është vlerësuar me gjithsej 42 pikë, kandidati me inicialet N.K është vlerësuar me gjithsej 38 pikë dhe kandidati me inicialet D.B është vlerësuar me gjithsej 36 pikë, duke propozuar që sipas këtij poentimi kandidati me inicialet A.K të transferohet në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Shitjeve Direkte, ndërsa kjo kandidate sipas Vendimit me numër DM 692/2023 të datës 29.09.2023 është transferuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Shitjeve Direkte.

Bazuar në raportet e cekura si më lartë, kandidatët që nuk kanë arritur të transferohen në këto dy pozita janë nxjerr aktet administrative nga Drejtori i Burimeve Njerëzore i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ku sipas Vendimit me numër DM 688/2023 të datës 28.09.2023 nëpunësja N.K është propozuar që nga data 01.10.2023 të transferohet në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori në institucion tjetër shtetëror dhe vendosje në listën e pritjes nga data 01.10.2023, Vendimit me numër DM 689/2023 të datës 28.09.2023 nëpunësi D.B është propozuar që nga data 01.10.2023 të transferohet në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori në institucion tjetër shtetëror dhe vendosje në listën e pritjes nga data 01.10.2023, Vendimit me numër DM 690/2023 të datës 29.09.2023 nëpunësi F.M është propozuar që nga data 01.10.2023 të transferohet në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori në institucion tjetër shtetëror dhe vendosje në listën e pritjes nga data 01.10.2023, Vendimit me numër DM 693/2023 të datës 29.09.2023 nëpunësi V.H është propozuar që nga data 01.10.2023 të transferohet në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori në institucion tjetër shtetëror dhe vendosje në listën e pritjes nga data 01.10.2023.

Ankuesi kundër Vendimit me numër DM 690/2023 të datës 29.09.2023 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më datë 29.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6292/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil; shkeljes së ligjit për procedurën e përgjithshme administrative dhe vërtetim jo të saktë të gjindes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa Këshilli më datë 12.10.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 07.11.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokoli 6918/2023 për shtyrje të afatit për vendosje të ankesës së ankuesit për 10 ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 6296/2023 të datës 29.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër DM 690/2023 të datës 29.09.2023 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 12.10.2023; Vendimin e datës 30.11.2023 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së; Emailin e datës 06.12.2023, 22.12.2022 nga PAK INFO për PAK ALL; Vendimin e datës 12.05.2023 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit; Vendimin e datës 14.02.2023 për ndryshimin e anëtarit të Komisionit të Ristrukturimit; Emailin e datës 23.12.2022 nga L.Xh për ankuesin; Emailin e datës 14.02.2023 nga L.Xh për T.M; Emailin e datës 13.02.2023 nga ankuesi për Burimeve Njerëzore; Emailin e datës 10.02.2023 nga Burimet Njerëzore për ankuesin; Përshkrimin e detyrave të punës për Udhëheqës të Divizionit të Zyrës Rajonale dhe Udhëheqës i Divizionit të Shitjeve Direke i datës 14.09.2023; Raporti i punës 04a/2023 i Komisionit të Ristrukturimit; Vendimin e datës 09.06.2023 për ankuesin; Vendimin DM 232/2023 i datës 19.06.2023; Vendimin A.nr.936/2023 të datës 01.09.2023 dhe A.nr.937/2023 i datës 04.09.2023 i Këshillit; Vendimin e datës 04.09.2023 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së; Vendimin DM 653/2023 i datës 29.08.2023 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit; Vendimin DM 666/2023 i datës 07.09.2023 për amendamentim të vendimin DM 653/2023; Raportin e Punës 07/2023 dhe Raportin e Punës 08/2023 i Komisionit të Ristrukturimit; Tabelat e sistemit të pikëzimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë dhe Udhëheqës i Divizionit të Shitjeve Direke për kandidatët B.B, A.K, V.H, F.M, N.K dhe D.B; Vendimin me

numër DM 688/2023 të datës 28.09.2023, Vendimin me numër DM 689/2023 të datës 28.09.2023, Vendimin me numër DM 691/2023 të datës 29.09.2023, Vendimi me numër DM 692/2023 i datës 29.09.2023, Vendimin me numër DM 693/2023 të datës 29.09.2023 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Emailin e datës 28.09.2023 nga A.G për F.M; Emailin e datës 29.09.2023 nga Burimet Njerëzore për ankuesin; Emailin e datës 02.10.2023 nga L.Xh për B.B, A.K, Q.B, A.K, A.L; Dosjet B.B, A.K, V.H, F.M, N.K dhe D.B.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës dhe mbi bazë të legjislacionit që rregullon këtë çështje, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, *Sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër DM 690/2023 të datës 29.09.2023 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pretendon se ky proces është përcjell me shkelje të vazhdueshme të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative duke filluar nga jo transparenca lidhur me përcjellën e vendimit të atakuar, vendimin mbi ndryshimin komisionit të ristrukturimit; Komisioni i ristrukturimit është themeluar në kundërshtim me Rregulloren Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil sepse në përbërjen e tij mungon një anëtar i ministrisë përkatëse; Poentimi i kandidatëve dallon në krahasim me vlerësimin paraprak; po ashtu ky proces është stërzgatur pasi që ka zgatur dy vite nga koha e nisjes. Tutje ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të njëjtit i propozon që të anulohet vendimi i atakuar me ankesë ose të anulohet komplet procesin e ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Kolegji i Këshillit, bazuar në pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se ky proces është përcjell me shkelje të vazhdueshme të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative duke filluar nga jo transparenca lidhur me përcjelljen e vendimit të atakuar, vendimin mbi ndryshimin komisionit të ristrukturimit, Kolegji i Këshillit, konstaton se me datë 06.12.2022 nëpunësit e Agjencinë Kosovare të Privatizimit kanë njoftuar stafin lidhur me vendimin e Bordit të Drejtorëve për miratimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës duke i dërguar edhe linkun ku nëpunësit mund të qasen për të shikuar ndryshimet. Me vetë faktin që ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër DM 690/2023 të datës 28.09.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, konsiston në faktin që ankuesi është njoftuar për vendimmarrjen sipas këtij vendimi, ndërsa lidhur me ndryshimin e vendimit të komisionit të ristrukturimit, Kolegji i Këshillit, konstaton se organi publik sipas nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka të drejtë të anulohet apo shfuqizoj aktin administrativ.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Komisioni i Ristrukturimit është themeluar në kundërshtim me Rregulloren Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil sepse në përbërjen e tij mungon një anëtar i ministrisë përkatëse, Kolegji i Këshillit, konstaton se Agjencia Kosovare e Privatizimit është agjenci e pavarur në Republikën e Kosovës e krijuar i tyre është paraparë me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila

funksionon në bazë të ligjit përkatës për Agjencinë Kosovare e Privatizimit gjegjësisht Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe e njëjta është paraparë edhe në shtojcën Nr. 1 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Ndërsa sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *"1. Fjalët apo shprehjet e tjera, të përdorura në këtë ligj, kanë këtë kuptim: 1.2. Institucion tjetër shtetëror - është administrata e Kuvendit, administrata e Presidentit, administrata e një institucioni të sistemit të drejtësisë, e një institucioni të pavarur, e një agjencie të pavarur apo e një komune"*, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk është institucion i administratës shtetërore, respektivisht procedurat e parapara sipas këtij ligji i kryen njësia përgjegjëse që në kuptim të nën paragrafit 1.6 të këtij ligji ka kuptimin: *"1.6. Njësi përgjegjëse - është Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, të institucioneve të administratës shtetërore, përkatësisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të institucionit dhe të institucioneve të tjera shtetërore"*, si rezultat i kësaj sipas nenit 54 paragrafi 3 të Ligjit të aplikuar Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *"3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit"*, ndërsa me nenin 14 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, është përcaktuar se: *"2. Komisioni udhëhiqet nga njësia përgjegjëse dhe përbëhet edhe nga dy anëtarë tjerë, të cilët janë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në Nenin 54. paragrafin 2 të Ligjit, sipas rastit"*. Bazuar në legjislacionin si më lartë dhe bazuar në gjendjen faktike, Drejtori i Burimeve Njerëzore i Agjencinë Kosovare të Privatizimit më datë 29.08.2023 ka nxjerr Vendim DM 653/2023 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit, ndërsa sipas Vendimit me numër DM 666/2023 të datës 07.09.2023 është plotësuar vendimi DM 653/2023, kështu që Komisionit të Ristrukturimit i vazhdohet afati i punës për 30-ditë nga data e nxjerrjes së këtij vendimi, kjo është bërë me arsyetimin se është miratuar Rregullorja Nr. 05/2023 për organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i lartcekur për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit është nxjerr në pajtim me kuadrin ligjor të sipërcekur, ngase për institucionin tjetër shtetëror siç është rasti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit nuk është paraparë që njëri nga anëtarët e Komisionit të Ristrukturimit mund të jetë jashtë këtij institucioni, respektivisht nuk është përcaktuar që njëri nga anëtarët e këtij komisioni mund të jetë nga ministria përkatëse në këtë rast Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Lidhur me procesin e ristrukturimit, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të nenit 54 të Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 13 paragrafi 1 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, me të cilin është përcaktuar se: *"1.Raste të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës"* dhe si rrjedhojë bazuar në frymën e këtyre normave juridike, Kolegji i Këshillit vlerëson se ristrukturimi është proces i ndryshimit të organizimit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe

fushëveprimet të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit kanë pësuar ndryshime të vendeve të punës, shkurtime (shuarje) të vendeve të punës apo ndryshime të kriterëve të vendeve të punës.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se poentimi i kandidatëve dallon në krahasim me vlerësimin paraprak, Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të Raportit të Punës 07/2023, Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë dhe Raportit të Punës 08/2023, Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Shitjeve Direkte, ka konstatuar se të gjithë kandidatët e vlerësuar në këto pozita kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në përshkrimin e detyrave të punës për pozitën përkatëse, ngase pozitën e tyre përkatëse me rregulloren e re për organizimin e Brendshme dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk janë paraparë.

Duke marr parasysh dokumentacionet e të gjithë kandidatëve që i janë nënshtruar procesit të vlerësimit nga ana e Komisionit të Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit për pozitën e cekura si më lartë, Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të mënyrës së vlerësimit të Komisionit të Ristrukturimit sipas Raportit të Punës 07/2023, Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë, konstaton se në bazë të dosjeve të këtyre kandidateve rrjedhë se kandidatja B.B lidhur me përvojën e punës prej 15 vitesh në shërbimin civil, ku nga janari 2012 ka ushtruar pozitën të nivelit drejtues e njëjta për përvojë të punës është vlerësuar me gjithsej 33 pikë gjegjësisht të formulari i vlerësimit të përvojës së punës tek numri i viteve të përvojës së punës në pozitën të ngjashme i janë llogaritur 12 vite është shumëzuar me 1.5 me gjithsej 18 pikë, ndërsa në koment kalkulimi është bërë në 12×1.25 , lidhur me vlerësimin e performancës në 5 vitet e fundit, konstatohet fakti se ankuesi në vitin 2018 është vlerësuar me notë të përgjithshme 4.51, në vitin 2019 me notë të përgjithshme 4.51, në vitin 2020 me notë të përgjithshme 4.4, në vitin 2021 me notë të përgjithshme 4.35 dhe në vitin 2022 me notë të përgjithshme 4.5, kështu që duke marr parasysh që në tri vite ka pasur vlerësim të shkëlqyeshëm edhe vlerësuar me nga 1.5 pikë për secilin vit ndërsa meqë në dy vitet të tjera ka pasur notë shumë mirë është vlerësuar me nga 1 pikë që në total është vlerësuar më 7 pikë ndërsa duhet të jetë 6.5 pikë. Lidhur me kualifikimin profesional kjo kandidate është vlerësuar me 9 pikë, ndërsa tek trajnimet është vlerësuar me 4 pikë, rrjedhimisht duke marr parasysh dosjen e kësaj kandidate e njëjta ka vetëm një Certifikatë të lëshuar nga IOM mirë e njëjta nuk është certifikatë përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar ndonjë trajnim, kështu që nuk ka ndonjë dëshmi që ka përfunduar ndonjë trajnim e që do të ishte i lidhur me funksionet e parashikuara në pozitën e punës, kurse në total nga të gjitha vlerësimet kjo kandidate ka marr 53 pikë.

Kandidati A.K është vlerësuar me gjithsej 52 pikë, për vjetërsinë në shërbimin civil është vlerësuar me 33.25 pikë, për vlerësimin të performancës është vlerësuar me 5 pikë, për kualifikimet profesionale me 9 pikë dhe për trajnimet me 5 pikë, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i dosjes së këtij kandidati rezulton se në dosjen e tij është evidentuar

vetëm një vlerësim i rezultateve në punës respektivisht ai i datës 23.01.2023 që është për vitin 2022 dhe nuk ka asnjë vlerësim tjetër, ndërsa ky kandidat është vlerësuar për performancën e vitit 2009, 2010, 2012, 2013 dhe 2022, në kundërshtim me Udhëzuesin Nr. 02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit, ngase në këtë rast duhet të merren në konsideratë vetëm vlerësimi i performancës vetëm për pesë (5) vitet e fundit përpara restrukturimit, ndërsa në mënyrë të njëjtë është vlerësuar edhe për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Shitjeve Direkte.

Kandidati V.H për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë është vlerësuar me gjithsej 51 pikë, ku për vjetërsinë në shërbimin civil është vlerësuar me 31.25 pikë, për vlerësimin e performancës me 5 pikë, për vlerësim të kualifikimit me 9 pikë, për vlerësim të trajnimeve me 6 pikë, ndërsa për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Shitjeve Direkte është vlerësuar me gjithsej 51 pikë, ndërsa pikët për kritere janë ndarë në mënyrë të njëjtë si në rastin për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë. Gjatë shqyrtimit të provave materiale respektivisht dosjes së këtij kandidati dhe formularëve të vlerësimit, gjegjësisht tek formuari i vjetërsisë në shërbimin civil ndërlidhur me numrin e viteve të përvojës së punës në pozitë të ngjashme mes pozitës Kryesues i Njesisë për Bujqësi dhe Pylltari me pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë është konstatuar nga 8 detyra në përgjithësi të ngjashme i ka 8 detyra dhe ka marr 2 pikë, ndërsa tek përlllogaritja nga 5 vite përvojë punë është shumëzuar me 1.75 ndërsa do të duhej me 2 për shkak që ka marr dy pikë, ndërsa lidhur me ngjashmërisë e pozitës Kryesues i Njesisë për Media tek përlllogaritje nga 10 vite përvojë punë është shumëzuar me 0.75, për shkak që nga 8 detyra të Udhëheqësit të Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë janë të ngeshme vetëm 3 detyra.

Ankuesi për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë është vlerësuar me gjithsej 43 pikë, ku për vjetërsinë në shërbimin civil është vlerësuar me 28 pikë, për vlerësimin e performancës me 6 pikë, për vlerësim të kualifikimit me 9 pikë, për vlerësim të trajnimeve me 0 pikë, ndërsa për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Shitjeve Direkte është vlerësuar me gjithsej 42 pikë, ku për vjetërsinë në shërbimin civil është vlerësuar me 27 pikë, për vlerësimin e performancës me 6 pikë, për vlerësim të kualifikimit me 9 pikë, për vlerësim të trajnimeve me 0 pikë.

Kandidatët e tjerë si N.K dhe D.B sipas Raportit të Punës 07/2023, Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë dhe Raportit të Punës 08/2023, Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Shitjeve Direkte, janë vlerësuar me gjithsej 38 pikë respektivisht 36, dhe mbi bazë të shqyrtimit të dosjeve dhe formularëve të vlerësimit janë larg pikëve të kandidatëve të lartcekur.

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh të gjitha rrethanat e kësaj çështje juridike-administrative, po ashtu duke marr parasysh se Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur më datë 04.09.2023, ka nxjerr Vendim me të cilin ka aprovuar Rregulloren Nr.05/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me arsyetimin se është konstatuar nga Bordi se Rregullorja aktuale ka

nevojë për rishikime/përmirësime, ku sipas nenit 43 është shfuqizuar Rregullorja Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, atëherë edhe çdo veprim juridik i filluar sipas Rregullores Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit është i konsumuar, ndërsa tashmë veprimet juridike ndërmerren në raport me procesin që derivon nga Rregullorja Nr.05/2023 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të konstatimeve të vlerësimit të kandidatëve sipas Raportit të Punës 07/2023, Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Zyrës Rajonale në Mitrovicë dhe Raportit të Punës 08/2023, Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për pozitën Udhëheqës i divizionit të Shitjeve Direkte, rezulton se ka mangësi në vlerësim siç është theksuar në arsyetimin e lartcekur, ngase Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk ka shqyrtuar drejtë faktet dhe dosjet e kandidatëve, kështu që në këtë rast raportet i ka përgatitur në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, frymën e dispozitave të Ligjit të aplikuar Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullon parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë, referencat që kanë të bëjnë me transferimin e nëpunësve civil si rezultat i ristrukturimit, dispozitave të nenit 14 paragrafi 5 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *“Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kritere: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet”*, si dhe hapave të përcaktuara përmes Udhëzuesit Nr. 02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit, kështu që këto raporte janë të paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankuesit lidhur me poentimin janë të bazuara.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se ky proces është stërzgatur pasi që ka zgjatur dy vite nga koha e nisjes, Kolegji i Këshillit, konstaton se procesi i ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka ardhur si rezultat i miratimit të Rregullores Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pastaj Komisioni i Ristrukturimit i themeluar sipas Vendimit DM 1118/22 të datës 14.12.2022 i ndryshuar me Vendimin DM 37/2023 të datës 14.02.2023, si rezultat i kësaj ky komision ka nxjerr raportin e ristrukturimit, rrjedhimisht palët e pakënaqura me procesin kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshillit përmes Vendimit A.nr.556/2023 ka anuluar raportin e komisionit të ristrukturimit dhe ka kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek ky organ. Pas ndërmarrjes së veprimeve nga Komisioni i Ristrukturimit prapë vie në shprehje procesi i ankimimit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli përmes Vendimit A.nr.865/2023, Vendimit A.nr.936/2023 dhe Vendimit A.nr.937/2023, ka anuluar sërish raportin e Komisionit të Ristrukturimit duke kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek ky organ. Rrjedhimisht ky proces nuk ka mund të përfundoj për shkak që sipas legjislacionit në fuqi palëve në procedurë i njihet e drejta për të kundërshtuar aktet e organeve publikë, respektivisht ky proces

do të përfundoj vetëm kur ka akt përfundimtar në procedurë administrative dhe kur shtjerrën të gjitha mundësit e ankimit, gjegjësisht kur akti administrativ plotëson kushtet për ekzekutim të përcaktuara me nenin 144 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë gjegjësisht Vendimit me numër DM 690/2023 të datës 28.09.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Këshillit, me qëllim të mos dëmtimit të palëve në procedurë, konstaton se procesi i ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka filluar në kohën kur në fuqi ka qenë Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe i njëjti aplikohet në këtë procedurë deri në bërjen e aktit administrativ përfundimtar, mirëpo Departamenti i Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit vendimin e kundërshtuar me ankesë e ka nxjerr duke ju referuar dispozitave të nenit 66 dhe 67 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kurse Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë në asnjë dispozitë ligjore nuk vepron në mënyrë retroaktive përveç rasteve të parashikuara me dispozitat kalimtare gjegjësisht me nenin 99 të këtij ligji. Bazuar në këtë, Kolegji i Këshillit, konstaton se procesi i ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk ka filluar sipas dispozitave të neni 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, por ky proces ka filluar sipas nenin 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që në këtë procedurë nuk mund të aplikohet neni 67 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ngase ky nen aplikohet vetëm nëse procesi i ristrukturimit ka filluar sipas nenit 66 të këtij ligji, rrjedhimisht në këtë rast nuk mund të aplikohet lista e pritjes, siç është vendosur me vendimin e kundërshtuar me ankesë, kështu që Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe i njëjti është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të këtij ligji, ngase me këtë vendim janë shkelur parimet e ligjit material respektivisht parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë të përcaktuar me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimet e ankuesit ndaj këtij vendimi janë të bazuara.

Nga ajo që u tha si më lartë, duke marr parasysh shkeljet evidentuara në vlerësim nga Komisioni i Ristrukturimit, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër DM 691/2023 i datës 29.09.2023 dhe Vendimi me numër DM 692/2023 i datës 29.09.2023 i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me frymën e dispozitave të cekura më lartë, për më tepër ky procesë ka filluar në kohën kur në fuqi ka qenë Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe i njëjti aplikohet në këtë procedurë deri në bërjen e aktit administrativ përfundimtar, mirëpo Departamenti i Burimeve Njerëzore i Agjencisë Kosovare të Privatizimit këto vendime i ka nxjerr duke ju referuar dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kurse Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë në asnjë dispozitë ligjore nuk vepron në mënyrë retroaktive përveç rasteve të parashikuara me dispozitat kalimtare gjegjësisht me nenin 99 të këtij ligji.

Andaj Kolegji i Këshillit, bazuar në konstatimet e sipërcekura, konstaton se Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është i obliguar që të rishqyrtoj në tersi procesin e ristrukturimit për pozitat e lartcekura, duke respektuar procedurat ligjore për rastin

konkret, duke respektuar konstatimet e këtij vendimi, dhe të vie në përfundim që nga ky proces mos të ketë veprimet që bie ndesh me procedurat ligjore.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1223/2023, datë 27/11/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së